



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 4 Datë 05.09.2017

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE  
“PËR PËRDORIMIN E BURIMEVE UJORE”

Në mbështetje të nenit 7, nenit 38 gërma b; nenit 41, nenit 50; nenit 51; nenit 52 dhe nenit 53 të ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore“ dhe të VKM Nr.416 datë 13.05.2015, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje për përdorim të burimeve ujore”, bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin – Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë:

V E N D O S I :

- 1- Të miratojë kërkesën e subjektit fizik “NIKO MARAÇAJ” për përdorim të burimit ujor **Pus shpimi (NM)** për qëllime turistike (Kamping - Restorant), me vendndodhje në fshatin Omaraj, Njësia Administrative Gruemirë, Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.  
Koordinatat e pusit të shpimit: X - 46 68 315; Y – 43 73 402; Z – +10 m;  
Koordinatat e pikës së shkarkimit: X - 46 68 249; Y – 43 73 397; Z – +12 m;  
Thellësia e pusit : 14 m;  
Diametri i pusit: 211 mm  
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti është 0.5 l/sek.  
Periudha e përdorimit të burimit ujor: Pranverë-Verë (5 muaj)
- 2- Leja e përdorimit të burimit ujor jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.
- 3- Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË  
SEKRETAR KRYETAR

Martin PLLUMBI



Paulin RADOVANI